

**LIGJ**  
**Nr. 105/2013**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 083, DATË 23.2.2009 “PËR  
MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË  
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE  
EVN AG, STATKRAFT AS E DEVOLL HYDROPOWER, SH.A., SI  
BASHKËKONCESIONARË PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN  
NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË  
HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Miratohet shtesa e dytë e “Kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower, sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë”, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Importi dhe furnizimi brenda vendit i mallrave dhe shërbimeve, që lidhen me projektin e hidrocentralit në lumin Devoll, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit (siç janë përkufizuar në kontratën e koncesionit, të ndryshuar), do t’i nënshtrohen regjimit specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar, siç përcaktohet në shtesën e dytë të kontratës së koncesionit. Dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm për tatimin mbi vlerën e shtuar nuk do të zbatohen nëse vijnë në kundërshtim me regjimin specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar, të përcaktuar në shtesën e dytë të kontratës së koncesionit.

**Neni 3**

Ngarkohet Ministria e Financave që, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim për zbatimin e nenit 2 të këtij ligji, si dhe të dispozitave të shtesës së dytë të kontratës së koncesionit, që lidhen me regjimin specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8096, datë 12.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**